

UDHËZIM
Nr.16, datë 8.5.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR SHPËRNDARJEN DHE RISHPËRNDARJEN
E FONDEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 87 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për mënyrën e shpërndarjes së fondeve publike subjekteve zgjedhore, që do të marrin pjesë në zgjedhje për Kuvendin, 2009 dhe për mënyrën e rishpërndarjes së fondeve publike subjekteve zgjedhore që do të përfitojnë mandate.

Neni 2

KQZ-ja me vendim cakton sasinë e fondeve që do të marrë secila prej partive politike, që plotëson kushtet e përcaktuara në germen “a” të pikës 2 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor (të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor, të ketë mandate në Kuvend dhe të ketë regjistruar listat shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvendin 2009), sipas rregullave më poshtë:

a) 50 për qind e fondit publik të vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore pjesëtohet me shumën e mandateve të fituara në zgjedhjet pararendëse nga partitë politike të përcaktuara në këtë nen, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 2005.

b) Çdo partie politike, të përcaktuar në këtë nen, i jepet ajo sasi nga fondet publike, që del nga shumëzimi i numrit të mandateve që ka marrë në zgjedhjet pararendëse me numrin e dalë nga pjesëtimi sipas germës “a” të këtij neni.

Neni 3

KQZ-ja me vendim cakton sasinë e fondeve që do të marrë secila prej partive politike që plotëson kushtet e përcaktuara në germen “b” të pikës 2 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor (të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor dhe të ketë marrë jo më pak se 2 mandate në Kuvend) sipas rregullave më poshtë:

a) 50 përqind e fondit publik të vënë në dispozicion për subjektet zgjedhore pjesëtohet me shumën e votave të fituara në zgjedhjet pararendëse në shkallë kombëtare nga partitë politike të përcaktuara në këtë nen, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve 2005.

b) Çdo partie politike, të përcaktuar në këtë nen, i jepet ajo sasi nga fondet publike që del nga shumëzimi i numrit të votave të marra në shkallë kombëtare prej saj, në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin, 2005, me numrin e dalë nga pjesëtimi sipas germës “a” të këtij neni.

Neni 4

Në rast se, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Kuvendin, 2009, nga KQZ, rezulton se partitë politike të cilat kanë përfutur fonde sipas nenit 3 të këtij udhëzimi dhe nuk kanë marrë asnjë mandat në zgjedhjet për Kuvendin, 2009, duhet të kthejnë shumën përkatëse të përfutur, sipas rregullave të përcaktuar në pikën 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor.

Neni 5

KQZ-ja me vendim do t’u rishpërndajë partive politike, të cilat do të përfitojnë mandate në Kuvend, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin, 2009, shumën e fondeve të kthyer sipas nenit 4 të këtij udhëzimi, duke u bazuar në rregullat më

poshtë:

a) Shuma e fondeve të kthyera nga subjektet zgjedhore sipas nenit 4 të këtij udhëzimi, pjesëtohet me shumën e mandateve të fituara në Kuvend në zgjedhjet e radhës nga partitë politike, e përcaktuar kjo, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin, 2009.

b) Çdo partie politike që përfiton fonde publike sipas këtij neni, i jepet ajo sasi nga fondi publik që del nga shumëzimi i numrit të mandateve të fituara prej saj në Kuvend me numrin e dalë nga pjesëtimi, sipas gurmës “a” të këtij neni.

Neni 6

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Arben Ristani